



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:017928

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753473

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Driton Sadiku, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në çështjen penale ndaj të pandehurit B. B. nga Gjakova, rr.”. . .”, 0. . ., për shkak të veprës penale lëndim i lehet trupor nga neni 185 par.1 nepar.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në vazhdim KPRK-së), si dhe ndaj të pandehurit E.F. nga fshati . . ., Komuna e Istogut, për shkak të veprës penale lëndim i lehet trupor nga neni 185 par.1 nepar.1.4 të KPRK-së, të akuzuara sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.883/2023, të datës 17.01.2024, duke vendosur për marrëveshjen e ndërmjetësimit Nd.nr.41/2024 e datës 14.05.2024, jashtë seancës, me datën 29.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.41/2024 e datës 14.05.2024, e lidhur në mes të pandehurit - dëmtuarit B. B. nga Gjakova, rr.”. . .”, . . ., si dhe të pandehurit - demtuarit E.F. nga fshati . . ., Komuna e Istogut, ashtu që;

HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.883/2023, të datës 17.01.2024 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit - dëmtuarit B. B., për shkak të veprës penale lëndim i lehet trupor nga neni 185 par.1 nepar.1.4 të KPRK-së dhe të pandehurit – dëmtuarit E.F., për shkak të veprës penale lëndim i lehet trupor nga neni 185 par.1 nepar.1.4 të KPRK-së, pasi që palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.883/2023, të datës 17.01.2024, ndaj të pandehurit B. B., për shkak të veprës penale lëndim i lehet trupor nga neni 185 par.1 nepar.1.4 të KPRK-së dhe të pandehurit E.F., për shkak të veprës penale lëndim i lehet trupor nga neni 185 par.1 nepar.1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 14.05.2024, në të cilën seancë kanë marrë pjesë prokurorja e shtetit Venera Shala, të pandehurat B. B. dhe E.F., ku pas leximit të aktakuzës gjykata i njoftoj palët lidhur me mundësin e zgjidhjes së kësaj çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, ashtu që të pandehurat propozuan që kjo çështje të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, po ashtu me këtë propozim u pajtua edhe prokurori i shtetit, për çka gjykata aprovoj propozimin e tyre dhe këtë çështje penale e referoj në procedurën e ndërmjetësimit.

Me datën 14.05.2024, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në prezencën e ndërmjetësuesit V.D., palët kanë arritur marrëveshje për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, duke deklaruar se e kuptojnë procedurën e ndërmjetësimit dhe vullnetarisht pajtohen që ta fillojnë këtë procedurë, pajtohen që të përmbahen nga ndonjë veprim tjetër juridik gjatë procedurës së ndërmjetësimit, janë informuar dhe i pranojnë shpenzimet e procedurës, përfshirë tarifën e ndërmjetësimit.

Po ashtu në të njëjtën ditë në mes të palëve është arritur edhe marrëveshja për zgjidhjen e kësaj çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, ku të pandehurit kanë deklaruar se iu vije keq për rastin i cili ka ndodhur në ditën kritike dhe i kërkojnë falje njëri tjetrit duke premtuar se raste të tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen, si dhe kanë deklaruar se të dyja palët raportet shoqërore i kanë të mira, ashtu që këtë marrëveshje me vendimin Nr.nr.41/2024 të datës 14.05.2024 e ka pranuar ndërmjetësuesja V.D.

Gjykata duke parasysh që palët kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit, pas vlerësimit të marrëveshjes, duke vepruar në bazë të dispozitave të nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që vlerësoj se e njëjta është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi, e cila marrëveshje në bazë të nenit 15

të Ligjit për Ndërmjetësimin, do të ketë fuqinë e dokumentit përmbarues nga data e aprovimit nga gjykata.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës është marr në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së

Gjykata duke u bazuar nga të cekurat si më lartë dhe në bazë të nenin 357 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së dhe nenit 11 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2024:017928, me datën 29.05.2024

Sekretarja juridike,
Mandushe Doli

Gjyqtari,
Driton Sadiku

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej tre (3) ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.